



DATA/DATUM/DATE	05.12.2024
NR/ BR	07 Nr./ <u>550</u>
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për asistentë/e për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta arsimore.
PËRMES/PREKO/THROUGH	Sektorit të administratës së Drejtorisë së Arsimit
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z.Afrim Llabjani
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Konkurs për asistentë/e për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Bazuar në nenin 08 të Ligjit të Punës 03/L-212, nenin 35 paragrafi 1,4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-32, neni 5 pika c, i Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, në nenin 8 pika 6 të Udhëzimit Administrativ të MASHTI-it, nr. 05/2021, Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm të MASHTI-it, të Rregullores së (QRK) Nr:19/2024, e datës 24.07.2024, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

KONKURS

Për pesë (5) asistentë/e për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta arsimore:

Kualifikimi i nevojshëm shkolla e mesme dhe niveli 5-të (postsekondar) **Pearson** asistent për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Paga bazë: **550 Euro**.

Detyrat dhe roli i asistentit/es për fëmijët/ nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

- Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me paisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatitë informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;

- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/ nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/ personale, mjeksore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/ mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi , mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/ kujdestarin e fëmijës/ nxënësit;
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës , sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;
- Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;
- **Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë**
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.
- Për vendin e punës për asistentë/e për fëmijë/ nxënës me nevoja të veçanta arsimore kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas nenit 8 pika 6 të Udhëzimit Administrativ të MASHTI-it, nr. 05/2021, Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm.
- Të drejtë aplikimi kanë kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse.
- Aplikacionet merren në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:

Aplikacionin për pozitën e punës të plotësuar
 Dimplomën, ose Çertifikatën e diplomës së kualifikimit të nivelit të pestë (5)-të PEARSON,
 kopje e vërtetuar,
 Ekstraktin e lindjes, kopje
 Kopjen e letërnjoftimit
 Çertifikatën nga Gjykata që nuk është nën hetime(origjinali)
 Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.
 Dokumentet e aplikimit nuk kthehen.

Informacione të veçanta : Çertifikatën shëndetësore kandidat/et e pranuar/a e sjellin në Drejtori të Arsimit para nënshkrimit të kontratës së punës.

Aplikimi bëhet në formë elektronike me dokumente të skanuara në programin PDF në emailin adresën: drejtoriaeArsimit.ferizaj@gmail.com fillon nga data 05.12.2024- dhe mbyllet në ora 16-të 19.12.2024.

Rezultatet shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e komunës së Ferizajt, në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>.